L I G J
Nr.9546, datë 29.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 "PËR AKCIZAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pika 4 e nenit 19 ndryshohet si më poshtë:
"4. Përjashtohet nga akciza sasia e karburantit, që do të përdoret për:
a) mekanikën bujqësore;
b) serrat me ngrohje;
c) subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit.
Përcaktimi i sasisë së karburantit dhe skema e përdorimit të tij bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.".

Neni 2

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4937, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCA 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore

I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	40 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	80 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	40 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëlsuese	2 lekë/litri
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto	30 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi	20 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese	20 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë/litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% ose më tepër	200 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatyruar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind.	130 lekë/litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind.	30 lekë litri
22 08 20 29	Raki	80 lekë/litri
IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	25 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër	35 lekë/litri
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	
27 10 11 51 27 10 11 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	46 lekë/litri

27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21	 Vajguret Karburantet, tip vajguri	 20 lekë/litri 0
27 10 19 31 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda (gazoil) si dhe vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	75 për qind, por jo më shumë se 33 lekë për litër dhe jo më pak se 13 lekë për litër
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte i kalçimuar ose jo	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyral; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg
VI	ARTIKUJ KOZMETIKE, PARFUMERI DHE TUALETI	
33 03 00 10 33 03 00 90 33 07 20 00	Parfume Ujëra tualeti Deodorante	60 për qind 60 për qind 60 për qind